



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Date: 03.03.2025
Numër Protokolli: 1527/2025

A.nr.102/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.102/2025, të datës 15.01.2025, të parashtruar nga ankuesja N.F., kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 03.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.102/2025, e datës 15.01.2025, e parashtruar nga ankuesja N.F.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, N.F.(*në tekstin e më tejme referuar: Ankuesja*), më datë 15.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e të drejtës për kompensim si anëtare e komisionit për llogaritjen e indikatorëve të shpenzimeve shëndetësore (National Health Account), sipas Vendimit të Ministrit të Shëndetësisë me numër Nr.45/2019 të datës 03.10.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo fundit, me datë 12.02.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesja, është e pasafatshme, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa më datë 03.10.2019 Ministri i Shëndetësisë, ka nxjerrë

vendimin me numër Nr.45/2019 dhe numër protokollit 05-5344, për themelimin e komisionit për llogaritjen e indikatorit vjetor të shpenzimeve shëndetësore me titullin (National Health Account), në përbërje prej dhjetë (10) anëtarëve, në mesin e tyre edhe ankuesja është caktuar si anëtare e këtij komisioni.

Më datë 05.03.2024, Kryesuesi i Komisionit për llogaritjen e indikatorit vjetor të shpenzimeve shëndetësore me titullin (National Health Account), ka parashtruar kërkesën me numër protokollit Nr.prot.05-1492 tek Njësia për Menaxhimin Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Shëndetësisë, duke kërkuar kompensimin e anëtarëve të komisionit për llogaritjen e indikatorit vjetor të shpenzimeve shëndetësore me titullin (National Health Account), për periudhën kohore nga muaji shkurt deri në muajin dhjetor 2023 e gjithashtu edhe për muajin janar 2024.

Ankuesja, më datë 15.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se nuk i është bërë kompensimi sipas Vendimit me numër protokollit Nr.prot.05-1492 të datës 05.03.2024, përmes të cilit ka qenë anëtare e komisionit për llogaritjen e indikatorit vjetor të shpenzimeve shëndetësore me titullin (National Health Account). Kërkon nga Këshilli që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të obligohet Ministria e Shëndetësisë të zbatoj vendimin përkatës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publike, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil*, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafi 1 dhe nenit 127 paragrafi 1, ku përcaktohet se: **Neni 124 paragrafi 1, 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...**, Neni 127 paragrafi 1: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*, dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja më datë 15.01.2025 është e pasafatshme, sepse bazuar në provat e lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë, si dhe thëniet si në ankesën e ankueses, kërkesa për kompensim është parashtruar më datë 05.03.2024, ndërsa, ankesën në Këshill për mos kompensim si anëtare e komisionit për llogaritjen e indikatorit vjetor të shpenzimeve shëndetësore me titullin (National Health Account) sipas vendimit me numër Nr.45/2019 dhe numër protokollit 05-5344 të datës 03.10.2019, ankuesja e ka parashtruar më datë 15.01.2025 pra jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e Nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që mbi këtë bazë ankesa e ankuesës me numër A.nr.102/2025 është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar nën 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje

Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.101/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses, N.F.;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*